

Njoftim për përqendrim me të cilin AGRANA Beteiligungs-AG do të fitojë kontroll të vetëm mbi Merkator –Emba proshim për ushqim (*Merkator-Emba proizvodnja za hrano d.o.o.*)

(Lënda nr. 08-142 /2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 02.10.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin AGRANA Internationale Verwaltungs- und Asset-Management GmbH, me seli të regjistruar në rrugën Friedrich-Wilhelm-Raiffeisen-Platz 1, 1020 Vjenë, Austri, me numër regjistrimi FN 197356 f, do të fitojë kontroll të vetëm mbi Merkator-Emba prodhim për ushqim d.o.o., me seli në Trzhashka cesta 2C, 1370 Logatec, Slloveni, me numër regjistrimi 5002516000.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste

Grupi i shoqërive AGRANA është një përpunues i lëndëve të para bujqësore, i strukturuar në tre divizione operative: sheqer, niseshte dhe fruta. Ai është furnizuesi kryesor i produkteve të niseshtesë dhe bioetanolit në Evropë, dhe kompani lider për sheqer në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore. Divizioni i frutave i AGRANA-s udhëhiqet nga AGRANA IFAM, përmes së cilës AGRANA synon të fitojë në mënyrë indirekte të gjitha pjesët dhe kontrollin e vetëm mbi Merkator-Emba.

Grupi AGRANA ka një shoqëri të varur në Maqedoninë e Veriut, shoqërinë AGRAGOLD SHPKNJP, me seli në Rr. Kaçanički Pat 168, 1000 Shkup, Maqedoni, me NUAS 6176640 dhe veprimtari të regjistruar 46.360 – tregti me shumicë me sheqer, çokollatë dhe ëmbëlsira. AGRAGOLD SHPKNJP vepron si një shoqëri distribucioni në tregun e Maqedonisë dhe është pjesë e një rrjeti shumë më të madh të shoqërive të distribucionit AGRANA-STUDEN dhe AGRAGOLD në Evropën Juglindore.

Merkator-Emba është një nga prodhuesit kryesorë të mbushjeve për deserte dhe kakao instante në Evropën Juglindore. Merkator-Emba prodhon një gamë të gjerë produktesh të përshtatshme për industrinë e qumështit dhe industrinë e produkteve si akullorja, siç janë produktet me bazë kakao/çokollatë/karamel, si dhe produkte me bazë frutash.

Merkator-Emba nuk ka prani të korporatës në Maqedoninë e Veriut, por gjeneron qarkullim përmes shitjeve ndërkufitare.

Për qëllimet e vlerësimit të këtij përqendrimi, parashtruesi i njoftimit propozon që si treg relevant të përcaktohet tregu i produkteve me bazë kakao, ose në mënyrë alternative tregu i produkteve gjysmë të gatshme me bazë kakao.

Në bazë të hetimit preliminar, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail:

kzk@kzk.gov.mk dhe ato duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

07.10.2025

Shkup